

Prot. 2211/231 K (e-k)

Datë, 22/11/2022, Tiranë

Lënda: *Partia Lëvizja Demokratike Shqiptare*

Gjetjet nga monitorimi i KRIIK mbi aktivitetin dhe raportimin

financiar të fushatës zgjedhore të vitit 2021!

Përshëndetje,

Në zbatim të kërkesës së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 3.11.2022 për t'ua përcjellë gjetjet e Raportit të KRIIK-ut Partive Politike si dhe duke përjashtuar gjetjet që tashmë janë përfshirë në raportin e përgatitur nga KQZ-ja, ju ridërgojmë në formë të përmbledhur dhe të personalizuar se *lidhur me subjektin LDSH, KRIIK ka konstatuar se:*

- financieri i partisë ka qenë njëkohësisht edhe kandidat i këtij subjekti;

- mungon bilanci i aseteve dhe detyrimeve.

Lidhur me financierin njëkohësisht edhe kandidat

Referuar raportit të vetëdeklarimit dhe listës shumëemërore të kandidatëve të Partisë Lëvizja Demokratike Shqiptare, financierja znj. Marcela Lala është edhe konkandidate me numër rendor 2 në Qarkun Fier.

Lidhur me bilancin e aseteve dhe detyrimeve

Sipas komunikimit shkresor me KQZ-në rezulton se LDSH nuk ka dorëzuar bilancin e aseteve dhe detyrimeve të partisë politike për periudhën nga dekretimi i datës së zgjedhjeve deri në datën e zgjedhjeve (pra nga data 6 shtator 2020 – 25 prill 2021), në zbatim dhe kuptim të detyrimit ligjor sipas nenit 92/3 “*Deklarimi dhe publikimi*” pika ç të Kodit Zgjedhor.

Duke ju falënderuar edhe njëherë për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin në vazhdimësi me ju,

Me konsideratë,

Për Koalicionin Për Reforma, Integrim

dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK)

Premto Gogo

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania